


► KUSHTET E PUNËS NË SEKTORIN MEDIATIKË:
**STATUSI PROFESIONAL
DHE TË DREJTAT E PUNËS
TË GAZETARËVE DHE
PUNONJËSVE MEDIATIKË**



Financuar nga
Bashkimi Evropian






Financuar nga
Bashkimi Evropian



► KUSHTET E PUNËS NË SEKTORIN MEDIATIKË:
**STATUSI PROFESIONAL
DHE TË DREJTAT E PUNËS
TË GAZETARËVE DHE
PUNONJËSVE MEDIATIKË**



**Titulli:**

Kushtet e punës në sektorin mediatik: statusi profesional dhe të drejtat e punës të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë

Botuesit:

Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë - SPGM
Instituti për hulumtim të zhvillimit shoqëror - RESIS

Autore e raportit:

Dr. Snezhana Trpeska

Anëtarë të ekipit hulumtues:

Snezhana Trpeska

Igor Miceski

Ljubinka Popovska

Jullijana Mladenovska

Darko Duridanski

Pero Momirovski

Përkthimi:

Jasmina Xhaferi

Rregullimi teknik:

Simon Simonovski

Kjo analizë është e punuar për nevojat e projektit “Të drejtat e punëtorëve për gazetari të pavarur”, që e zbatojnë së bashku Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë dhe Instituti për Hulumtim të Zhvillimit Shoqëror RESIS, me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian


Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autores dhe botuesve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Përmbajtja

Parathënie	5
1. Hyrje dhe vërejtje metodologjike.....	7
1.1. Qëllimi i hulumtimit	7
1.2. Popullsia dhe mostra	7
1.3. Mënyra e zbatimit të anketës.....	8
1.4. Të dhëna për popullsinë totale të gazetarëve dhe punonjësve të mediatikë	8
1.5. Profili i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të anketuar.....	10
2. Statusi i punës dhe ngarkesa e punës	13
2.1. Llojet e marrëdhënies së punës.....	13
2.2. Ngarkesa e punës (koha e punës, e drejta e pushimit, stresi në punë)	14
3. E drejta për fitim - paga dhe shtesa.....	18
3.1. Shuma e pagave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë	18
3.2. Lartësia e pagave sipas gjinisë	20
3.3. Rregullsia e pagave dhe mënyra e pagesës	21
3.4. Shtesa për punë jashtë orarit dhe punë në ditë festash.....	22
4. Të drejtat që lidhen me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor	24
4.1. E drejta e sigurimit shëndetësor	24
4.2. Të drejtat që rrjedhin nga sigurimi shëndetësor.....	25
5. Kënaqësia me punën dhe mjedisin më të gjerë.....	26
5.1. Karriera, edukimi dhe kualitet të përmbajtjes së krijuar.....	26
5.2. Balanca ndërmjet punës dhe jetës private dhe vlerësimi i punës	27
5.3. Mbështetje nga eprorët dhe kolegët	28
5.4. Autonomia personale dhe perceptimet për liritë e medias në vend	29
6. Organizimi sindikal.....	31
6.1. Anëtarësimi në organizata sindikale	31
6.2. Perceptime të përgjithshme për punën e sindikatave	32
7. Përfundime dhe rekomandime.....	34
8. Literatura e shfrytëzuar	39







Parathënie


Nga pavarësia e Maqedonisë dhe zhvillimi i demokracisë pluraliste janë zhvilluar edhe liria dhe pluralizmi në sistemin mediatik. Që në vitet e para të liberalizimit të sistemit mediatik në vend u hapën një numër i madh mediash private të shtypura dhe radiodifuzive. Megjithatë, numri i madh i mediave, vetvetiu nuk solli kualitet, profesionalizëm dhe shumëllojshmëri në përmbajtjet. Përkundrazi numri i madh i mediave maksimalisht e intensifikoi konkurrencën për fondet tashmë të vogla të reklamave në vend. Shërbimi publik radiodifuziv, përsëri, edhe pse kaloi nëpër disa tentativa për t'u transformuar, mbeti i marginalizuar, ndërsa në sektorin jofitimprurës, mezi pak media arrinin të mbijetonin. Teknologjitë digjitale, interneti dhe rrjetet sociale në mënyrë shtesë e ndërlikuan situatën, duke i ndryshuar rrënjësisht zakonet e audiencës, duke i minuar modelet tash më të dobëta të biznesit të mediave dhe duke vendosur një sërë pyetjesh për atë se cilat janë pasojat negative të këtyre ndryshimeve mbi statusin e punës dhe të drejtat e punës të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Në vitet e kaluara, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediaticë në mënyrë të vazhdueshme punonte mbi një sërë çështjesh të lidhura me përmirësimin e statutit të punës dhe të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve mediaticë. Megjithatë, për zhvillimin e një periudhe të përshtatshme strategjike ndaj këtyre çështjeve, një prej problemeve kryesore ishte mungesa e të dhënave precize, së pari për numrin dhe strukturën e të punësuarve në të gjitha sektorët mediaticë dhe, së dyti, mungesa e hulumtimeve relevante për atë se çfarë vet gazetarët dhe punonjësit mediatic dinë dhe mendojnë për statusin e tyre të punës dhe për kushtet në të cilat çdo ditë i kryejnë detyrat e tyre, bashkë me kolegët e tyre xhirues, fotoreporterë, regjisorë, producentë dhe kuadër tjetër. Kjo do të thoshte se ishte e vështirë të hartohej dhe të strukturohej çfarëdo qoftë politikë ose aktivitet për përmirësimin e statutit të tyre profesional dhe socio-ekonomik.

Prandaj, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatic, bashkë me Institutin për Hulumtim të Zhvillimit shoqëror – RESIS, në vitin 2023, për herë të parë bënë një hartim të popullatës gazetareske dhe të punonjësve mediaticë, e cila më tej paraqiste bazë për realizimin e hulumtimit, nga i cili ishin mbledhur një numër i madh i të dhënave për statutin e tyre shoqëror, ekonomik dhe profesional, si dhe për perceptimet e tyre për mjedisin e tyre të punës, por edhe për mjedisin më të gjerë mediatic.

Të dhënat nga anketa e zhvilluar treguan se disa aspekte të statutit të punës të gazetarëve dhe punonjësve mediaticë gjatë viteve janë ndryshuar për më mirë, por disa kanë ngel të njëjta siç kanë qenë edhe gjatë viteve 1990. Për shembull, me rëndësi është të përmendet se angazhimi në bazë të honorarit të gazetarëve dhe punonjësve mediaticë, në krahasim me të kaluarën, është një dukuri shumë më e rrallë, por ende mbetet fakti që një pjesë e madhe e gazetarëve dhe punonjësve mediaticë paguhen nën pagën mesatare në vend. Për më tepër, edhe pse respektimi i të drejtave të punës ndryshon nga media në media, hulumtimi tregoi se ekzistojnë të drejta themelore të punës që shkelen shumë shpesh, siç është, për shembull, e drejta e gazetarëve dhe punonjësve të medias për pushim ditor dhe javor dhe e drejta e pagesës së orëve të punës jashtë orarit të punës dhe puna gjatë festave.





Lexuesit, ato që do të interesohen për këtë temë, do të kenë mundësi të gjejnë këtu një numër të madh të dhënash interesante dhe të rëndësishme. Përveç asaj, ky publikim mund të jetë i dobishëm, jo vetëm për ata që e hulumtojnë këtë temë, por edhe për organizatat të cilat i mbrojnë të drejtat e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë, veprimtarin e saj të mëtejme natyrisht do ta bazojë në gjetjet nga ky hulumtim dhe do të përpiqet t'i shfrytëzojë më së miri që mundet në luftën solidarë për një statut më të mirë socio-ekonomik dhe për lirin e shprehjes dhe informimit.

Pa status të sigurt socio-ekonomik, nuk mund të kemi gazetari të lirë dhe profesionale.

Përsëndetje solidariteti,
Pavle Bellovski,
kryetarë i SPGM-së.



1. Hyrje dhe vërejtje metodologjike

1.1 Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit “Të drejtat e punëtorëve për gazetari të pavarur”, të cilin e realizon Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (www.ssnm.org.mk) bashkë me Institutin RESIS (www.resis.mk), ndërsa me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Në kuptimin më të gjerë, qëllimi kryesor i hulumtimit është që t’u ndihmojë organizatave gazetareske, hulumtuesve të mediave dhe të gazetarisë, praktikuesve dhe politikëbërësve t’i kuptojnë më mirë pozicionin dhe rolin e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në mjedisin profesional në të cilin punojnë dhe në mjedisin e ndryshueshëm mediatikë.

Një nga aktivitetet e para të projektit ishte që të zbatohet një anketë me gazetarët dhe punonjësit mediatikë në vend, që do të mundësojë të fitohen të dhëna precize për: (1) statusin socio-ekonomik dhe respektimin e të drejtave të punës të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, dhe (2) qëndrimet dhe perceptimet e gazetarëve të redaksioneve informative për autonominë editoriale, ndikimet dhe etikën profesionale. Në këtë raport janë të paraqitura vetëm gjetjet nga pjesa e parë e anketës.

1.2 Popullsia dhe mostra


Pyetëtori për anketën, në pjesën që ka të bëjë me të drejtat e punës, ishte i punuar në bazë të analizës së hulumtimeve të ngjashme të realizuara më parë në vende të tjera nga rajoni dhe të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane në sferën e të drejtave të punës, veçanërisht duke e marrë parasysh Kartën për Kushtet e Punës së Gazetarëve të Federatës Evropiane të Gazetarëve. Me qëllim që të sigurohet precizitet maksimal dhe të kuptohen pyetjet e bëra, para se të fillojë anketa, u bë testim i pyetëtorit me një numër të caktuar të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Që të dizajnohet një mostër reprezentuesve e anketës, në bazë të më tepër burimeve të ndryshme të të dhënave¹, së pari ishte e punuar korniza e mostrës që përbëhej nga një listë e pozitave të punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të sektorëve të ndryshëm mediatik. Për çdo pozitë të punës në kornizën ishin të siguruara të dhëna për llojin e vendit të punës sipas kategorizimit të vendeve të punës të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe për gjininë e personit të punësuar.

Lista e pozitave të punës ishte e ndarë në nëntë shtresa: MTV, televizione kombëtare private, televizione regjionale dhe lokale private, Radio Maqedonase, radiot kombëtare private, radio-stacione regjionale dhe lokale, media të shtypura, media - online dhe agjencia gazetareske MIA. Pastaj, nga lista për çdo shtresë, në mënyrë të rastësishme ishin të gjeneruara pozitat e punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që duhet të jenë të përfshirë në anketën. Gazetarëve-anketues u ishte dhënë ajo listë me instruksione të detajuara se si në kornizat e çdo medie duhet në mënyrë të rastësishme t’i zgjedhin gazetarët dhe punonjësit mediatikë që duhet të inkuadrohen në anketë.

Numri i përgjithshëm i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që ishte i përcaktuar me hartimin e kësaj popullate, të kryer para se të fillonte anketimi, arrin në 3.146 pozita pune, nga të cilat

1 Për sektorin audiovizuel u shfrytëzuan të dhëna nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuele, ndërsa për mediat e shtypura, MIA dhe onlajn – mediat u kërkuan të dhëna nga të gjithë mediat e ndara. Lista e onlajn-mediave u përcaktua në bazë të të dhënave nga Regjistri Vullnetar të Mediave Profesionale “Promedia”, të fituara nga Këshilli për Etikë në Media. Për ato media që nuk i dorëzuan të dhënat deri te SPGM, u shfrytëzuan të dhënat e publikuara në impresumin e medias së caktuar.



1.694 janë gazetarë, ndërsa 1.452 janë punonjës mediatikë. Mostra e zgjedhur rastësisht në anketë përbëhej nga gjithsej 343 të anketuar, prej të cilëve 206 janë gazetarë dhe 137 janë punonjës mediatikë. Ajo, sipas standardeve në hulumtimet sociologjike, llogaritet për një mostër e mirë, me nivel të besueshmërisë 95 për qind dhe interval të besueshmërisë (margjina e gabimit) prej 5 për qind.

1.3 Mënyra e zbatimit të anketës

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë fituar mbi bazë të anketës 'ballë për ballë', të cilën e zbatoi një ekip prej 17 gazetarë-anketues, të cilët paraprakisht fituan trajnim të veçantë dhe udhëzime të detajuara për atë se si t'u qasen dhe si t'i anketojnë kolegët e tyre gazetarë. Ajo ishte e një rëndësie vendimtare që të zvogëlohet numri i refuzimeve dhe të realizohet komunikim i mirë dhe i sigurtë me gazetarët dhe punonjësit mediatikë që ishin të inkuadruar në mostër. Në raste të ndara, kur nuk ishte e mundur të realizohet intervistë 'ballë për ballë' me të anketuarin, është zbatuar online-intervista (nëpërmjet Zoom-it, Skajp-it ose aplikacioneve të ngjashëm). Anketimi është zbatuar në periudhën prej 1 korrik deri më 31 dhjetor 2023.

Gjatë zbatimit të anketës iu kushtua vëmendje e veçantë transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale të të anketuarve. U përgatit një fletë me informata të veçanta dhe intervistuesit u ngarkuan të informojnë kolegët e tyre në detaje për qëllimin e anketës, organizatat që kryejnë atë, kohëzgjatjen e intervistës, si dhe faktin që pjesëmarrja në anketë është vullnetare dhe anonime. Të gjitha të dhënat e mbledhura për të anketuarit janë anonime, dhe përgjigjet e tyre përpunohen dhe paraqiten në formë të përmbledhur.

1.4 Të dhëna për popullsinë e përgjithshme të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë

Që të zbatohet një anketë në mënyrë të suksesshme, hapi i parë është që të sigurohen të dhëna sa më të sakta për popullsinë për të cilën hulumtuesi dëshiron të nxjerrë përgjithësi nga gjetjet e fituara nga anketa. Çdo anketë kryhet në një prerje të zgjedhur (mostër) të popullatës, e cila duhet të përfaqësojë në mënyrë adekuate heterogjenitetin e asaj popullate. Prandaj, detyra e parë e ekipit hulumtues, para se të fillonte hartimin e mostrës të të anketuarve me të cilën do të zhvillohet anketa, ishte që të mblidhen të dhëna sa më të sakta për popullatën e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në sektorë të ndryshëm mediatik.

Hapi i parë në hartimin e popullsisë ishte përcaktimi i numrit dhe llojit të mediave në vend. Për mediat tradicionale (radio, televizion, media e shkruar), të dhënat për numrin dhe llojin e mediave janë marrë nga regjistrat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Megjithatë, ishte shumë më e vështirë për mediat-online të bëhet një rishikim i tillë, sepse nuk ka një regjistër zyrtar të mediave - online të regjistruara në vend. Prandaj, si pikë fillimi, është marrë lista e mediave - online nga regjistri vullnetar i mediave profesionale "Promedia", pranë Këshillit të Etikës në Media. Pastaj, ajo listë u plotësua me të dhëna për mediat -online të mbledhura me ndihmën e aktiviteteve të SPGM-së dhe të dhëna nga agregatori Time.mk. Në fund, ekipi hulumtues bëri kontroll të çdo medie - online nga lista, me qëllim të kontrollohet media a punon ende në mënyrë aktive, gjegjësisht a publikon informata.



Lloji i medias	Numri i shërbimeve/mediave
Shërbimi publik (MTV)	5 shërbime + kanali i Kuvendit 2 satelitore
Kombëtare (private) TV stacione (11)	5 nëpërmjet DTT 4 nëpërmjet kabllit + 2 nëpërmjet satelitit
TV stacione private regjionale dhe lokale	10 regj. Nëpërmjet DTT, 6 regj. Nëpërmjet kabllit, 14 lokale nëpërmjet kabllit
Shërbim publik (RAM)	3 shërbime
Radiostacione kombëtare	4 përmes transmetuesve tokësorë
Radiostacione rajonale dhe lokale (58 juridike dhe 4 jofitimprurëse)	17 regjionale dhe 45 lokale nëpërmjet transmetuesit tok.
Media të shkruara	17 (gazeta ditore, javore etj.)
Online-media	122 juridike dhe 7 jofitimprurëse
Agjenci informative	1 (MIA)

Tabela.1 Numri dhe lloji i mediave sipas sektorëve të ndryshëm të medias


Hapi i dytë në procesin e hartimit konsistonte në mbledhjen dhe kontrollimin e të dhënave për numrin dhe strukturën e gazetarëve dhe punonjësve të medias të punësuar rregullisht dhe kohë pas kohe. Edhe në këtë fazë, ekipi hulumtues përdori më shumë burime dhe teknika për mbledhjen e të dhënave. Për sektorin audiovizuel mediatikë u përdorën të dhëna të fituara nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që i referohen situatës për dhjetor 2022. Pastaj, ekipi hulumtues bëri kontrollim shtesë të këtyre të dhënave me qëllim të kontrolloj, nëse në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2023 ka pasur ndryshime në numrin dhe strukturën e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të radiot ose televizionet.

Për dy sektorët tjerë- mediat e shkruara dhe online, deri te të gjithë mediat në listë u dërguan formularë të veçanta. Për të arritur konsistencën e të dhënave për të gjithë sektorët e medias, është përdorur kategorizimi i pozicioneve të punës i miratuar nga rregullatori i medias. Këtu duhet të theksohet se grumbullimi i të dhënave për këto sektorë ishte mjaft kompleks sepse një numër i caktuar mediash, veçanërisht nga sektori – online, nuk i dorëzuan informatat e kërkuara, pavarësisht përkujtimeve të disahershme. Në këto raste, që të arrihet të paktën deri te informatat e përafërta, ekipi hulumtues përdori burim tjetër: impresimet e publikuara me emrat e personave të angazhuar në redaksitë ose vlerësimet në mënyrë indirekte u fituan nga aktivistët të SPGM-së që i njihnin gazetarët e angazhuar në ato medime.

shtresa	pozita gazetareske	pozita të punonjësve mediatikë	gjithsej	%
MTV	218	270	488	15.51%
Stacionet televizive kombëtare	338	642	980	31.15%
Stacione televizive lokale dhe rajonale	139	101	240	7.63%
RAM	96	59	155	4.93%
Radiostacionet kombëtare	23	38	61	1.94%
Radio stacionet lokale dhe rajonale	177	75	252	8.01%
Media të shkruara	123	72	195	6.20%
Online-media	520	161	681	21.65%
MIA	60	34	94	2.99%
Gjithsej	1694	1452	3146	100.00%

Tabela.2 Pozita pune të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë






Si rezultat i hartimit të zbatuar, u bë një listë prej gjithsej 3.146 pozitave të punës në të gjithë sektorët mediatikë, prej të cilëve 1.694 janë pozita pune të gazetarëve, ndërsa 1.452 të punonjësve mediatikë. Prej numrit të përgjithshëm, 2.111 janë punësime të rregullta, ndërsa 1.035 janë pozita pune të personave të angazhuar përkohësisht.

Është e rëndësishme të bëhen dy vërejtje këtu. Së pari, numri i përgjithshëm i vendeve të punës nuk do të thotë që në realitet punësohen kaq shumë gazetarë dhe punonjës mediatikë. Gjatë verifikimit të të dhënave, ekipi hulumtues konstatoi se një numër i konsiderueshëm individësh shfaqen në media të ndryshme. Kjo veçanërisht vlen për personat e angazhuar me honorar. Prej këtu, të dhëna të sakta për numrin aktual të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të punësuar mund të përcaktohen vetëm për personat e punësuar rregullisht, ndërsa për numrin real të punonjësve të angazhuar në bazë të honorarit ose përkohësisht mund të bëhen vetëm vlerësime. Së dyti, gjatë grumbullimit të të dhënave, ekipi konstatoi se numri dhe struktura e fuqisë punëtore në sektorin mediatik vazhdimisht ndryshon: disa televizione dhe radio lokale pushuan së punuari, ose disa media (veçanërisht lokale) kanë larguar punonjës nga puna për shkak të gjendjes së keqe financiare.

1.5 Profili i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të anketuar

Që të fitohen përgjigje nga gazetarët dhe nga punonjësit mediatikë që punojnë në sektore të ndryshme mediatike, e gjithë popullata ishte e ndarë në nëntë shtresa. Pastaj, në bazë të listës së pozitave të punës në çdo shtresë, me anë të kompjuterit u gjenerua një mostër e zgjedhur rastësisht e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në çdo shtresë.

Këtu është e rëndësishme të theksohet nevoja për interpretim të kujdesshëm të të dhënave të marra nga anketa. Siç shihet nga të dhënat e hartimit, e gjithë popullata e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë është një grup heterogjen i përbërë nga shumë nën sektorë. Secili prej këtyre nën sektorëve ka specifikat e veta dhe, për rrjedhojë, pozicioni i gazetarëve ose punonjësve të medias mund të ndryshojë ndjeshëm nga sektori në sektor. Por të dhënat e anketës japin vetëm pasqyrë të situatës në nivel të përgjithshëm - për të gjithë popullsinë e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të përfshirë në mostër, që mund të jetë e ndryshme nga situata në ndonjë sektor specifik. Për shembull, statusi socio-ekonomik i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në radiostacionet lokale është shumë më i keq se ai i kolegëve të tyre në shërbimin publik ose në një pjesë të stacioneve televizive private në nivel kombëtar. Por, numri i të anketuarve të përfshirë në anketë është shumë i vogël për të qenë në gjendje të nxirren përfundime statistikisht relevante për të gjithë gazetarët dhe punonjësit mediatikë të angazhuar në këtë sektor. Përgjithësimet përkatëse mund të bëhen vetëm në nivelin e të gjithë popullatës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë dhe për ato shtresa ku numri i të anketuarve është më i madh, përkatësisht: shërbimi publik, stacionet televizive kombëtare dhe sektori i medias-online.



Shtresat	Gazetarë	Punonjës mediatikë
MTV	29	27
Stacionet televizive kombëtare	54	64
Stacione televizive lokale dhe rajonale	9	5
RAM	11	5
Radiostacionet kombëtare	4	4
Radiostacionet lokale dhe rajonale	12	3
Mediat e shkruara	16	9
Online-mediat	67	14
MIA	4	6
GJITHSEJ	206	137


Tabela.3 Struktura e të anketuarve të përfshirë në mostrën sipas shtresave

Struktura e mostrës, sipas gjinisë, moshës, arsimit dhe përkatësisë etnike, është si më poshtë:

- Në mesin e gazetarëve, numri i gazetarëve meshkuj (49%) dhe gazetarëve femra (51%) të përfshirë në anketë është pothuajse i barabartë. Në mesin e punonjësve mediatikë ka një numër më të madh të të anketuarve meshkuj (68%), që është afër situatës reale. Të dhënat e hartimit tregojnë se raporti është 70% (meshkuj) kundrejt 30% (femra).
- Profili arsimor i të anketuarve e shpreh specifikën e të dy profesioneve: pjesa më e madhe e gazetarëve² të intervistuar kanë mbaruar arsim të lartë (72%) ose studime master (14%); ndërsa, tek punonjësit mediatikë dominojnë të anketuarit me arsim të mesëm (63%).
- Sipas moshës, tek gazetarët më i përfaqësuar është grupi prej 41 deri më 50 vjeç, megjithëse nuk është i papërfillshëm përfaqësimi i grupmoshave më të reja. Popullsia e gazetarëve nën moshën 40 vjeç është 38.3 për qind. Grupmoshat më të vjetra dominojnë në mesin e punonjësve të medias, dhe popullsia deri në 40 vjeç është 30.8 për qind.
- Sipas përkatësisë etnike, ishin përfshirë gazetarë dhe punonjës mediatikë nga të gjitha grupet etnike.

2 Duhet pasur parasysh se këto të dhëna janë marrë në bazë të vetë-raportimit nga të anketuarit. Të dhënat e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale japin një pasqyrë pak më ndryshe të strukturës arsimore të gjithë popullatës së gazetarëve në sektorin audiovizuel. Kështu, në fund të vitit 2022, në stacionet televizive dhe radiofonike ishin të punësuar gjithsej 827 gazetarë, nga të cilët 80,5% kishin arsim të lartë dhe 19,5% me arsim të mesëm. Sipas anketës, përqindja e gazetarëve të intervistuar me arsim të mesëm është disi më e ulët -- 13 për qind.





Karakteristika socio-demografike	Gazetarët	Punonjësit	In total
mediatikë	Gjithsej		
Burra	49%	68%	56%
Gra	51%	32%	44%
Arsimimi			
Studime doktrature	5%		3%
Studime master	14%	7%	11,4%
Studime deridiplomike	72%	29%	55,1%
Fillova të studioj, por nuk kam diplomë	7%	26%	14,6%
Kam mbaruar shkollën e mesme	6%	37%	18,4%
Nuk kam mbaruar shkollën e mesme		1%	3%
Mosha			
19-30	16,5%	13,2%	16,5%
31-40	21,8%	17,6%	21,8%
41-50	34,0%	33,1%	34,0%
51-60	19,4%	32,4%	19,4%
60+	8,3%	3,7%	8,3%
Përkatësia etnike			
Maqedonas	78%	72%	76%
Shqiptar	17%	20%	18%
Të tjerë	5%	8%	6%

Tabela.4 Karakteristikat socio-demografike të mostrës së të anketuarve



2. Statusi i punës dhe ngarkesa e punës

2.1. Llojet e marrëdhënies së punës

Lloji i marrëdhënies së punës është i një rëndësie të veçantë për realizimin e të drejtave të punës së gazetarëve dhe të punonjësve mediatikë. Punësimi i rregulluar, përmes lidhjes së kontratës së punës, u mundëson gazetarëve dhe punonjësve të medias të fitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe rregulloret e tjera në fushën e punës, si dhe me rregulloret që u garantojnë atyre sigurimin social (sigurimin shëndetësor, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin në rast të papunësisë).

Marrëdhënia e punës, që rregullohet me kontratë për punësim, është një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet dy palëve - punëmarrësit dhe punëdhënësit. Kjo do të thotë se punëmarrësi merr pjesë vullnetarisht në procesin e punës të organizuar nga punëdhënësi, kryen punë të rregullt sipas rregullave dhe udhëzimeve të punëdhënësit dhe merr pagë të rregullt dhe përfitime të tjera për punën e tij. Këta janë tregues kryesorë për dallimin e marrëdhënies së punës nga marrëdhëniet e tjera kontraktuale, si kontratat në vepër ose kontratat e të drejtave të autorit. Personat të cilët punësohen në bazë të kontratave të tilla nuk mund t'i gëzojnë të drejtat e garantuara me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës dhe rregulloret tjera ligjore.

Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, kontrata e punës mund të lidhet për një kohë të caktuar ose të pacaktuar³. Kontrata e punës në kohë të pacaktuar siguron status më të sigurt të punës për punonjësin dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave të tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Kontrata e punës me afat të caktuar mund të lidhet për një kohë të caktuar për të kryer të njëjtën punë, me ose pa ndërprerje, më së shumti për 5 (pesë) vite⁴. Qëllimi i kësaj dispozite është të parandalohet shfrytëzimi i punonjësit nëpërmjet lidhjes së shumëfishtë të kontratave për punësim me orar shkurtuar dhe kontratës për punësim me afat të caktuar me orar të shkurtuar (e cila mund të lidhet me një ose me më shumë punëdhënës).

Llojet e tjera të kontratave të punës, sipas të cilave mundësohet punësimi i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, janë të ashtuquajturat. kontrata fleksibël ose atipike, të cilat përfshijnë: kontratën e punës në kohë të pacaktuar me orar të shkurtuar të punës dhe kontratën e punës me kohë të caktuar me orar të shkurtuar të punës (e cila mund të lidhet me një ose më shumë punëdhënës).


Është fakt se në të kaluarën mbizotëronte besimi se është i madh numri i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që nuk kishin punësim të rregullt, gjegjësisht se janë shpesh të angazhuar ose me kontrata në kohë të caktuar ose në bazë të honorarit dhe, prej këtu, kanë statut pune të pasigurt⁵. Por, si rezultat i forcimit të masave të ndërmarra nga institucionet përkatëse dhe aktiviteteve të sindikatave, përfshirë edhe SPGM-në, në vitet e fundit, kjo situatë ka ndryshuar ndjeshëm.

3 Neni 14 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës përcakton se (1) kontrata e punës lidhet për një periudhë kohëzgjatja e së cilës nuk është përcaktuar paraprakisht (marrëdhënie e punës me kohëzgjatje të pacaktuar), si dhe për një periudhë kohëzgjatja e së cilës është përcaktuar paraprakisht. (marrëdhënie pune në kohë të caktuar). Gjithashtu, kjo dispozitë shton se nëse në kontratën e punës nuk është përcaktuar koha për të cilën është lidhur, atëherë do të konsiderohet punësim për një periudhë të pacaktuar.

4 Neni 46 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

5 Puna e pavarur: Një ushtri gazetarësh detyrohen të punojnë "në të zezë", botuar në "Libri i bardhë për të drejtat profesionale dhe të punës së gazetarëve", Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë - SPGM, Shkup: 2014. Në dispozicion në: eprints.ugd.edu.mk






Nga numri i përgjithshëm i gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që ishin të inkuadruar në anketën, dhe te të dy kategoritë, rreth 70 për qind e të anketuarve janë deklaruar se kanë kontratë për punësim për periudhë të pacaktuar me orar të plotë të punës, 17 për qind në kohë të caktuare (orar i plotë i punës) dhe 7 për qind e të anketuarve gjegjësisht 9 për qind janë të angazhuar me honorar, me kontratë për të drejta autoriale dhe me kontratë në vepër. Kjo do të thotë se rreth një çerek i gazetarëve (24%) dhe punonjës mediatikë (26%) nuk kanë punësim që u mundëson në tërësi status pune të qëndrueshëm dhe të sigurt. Natyrisht, grupi më vulnerabel, në aspektin e statusit të punës dhe të drejtave të punës, janë gazetarët dhe punonjësit mediatikë, të cilët në periudhën e zbatimit të anketës kanë qenë të angazhuar në bazë të kontratës në vepër ose kontratës për të drejta autoriale.

Punësimi me kontratë për një periudhë të caktuar kohore është më i zakonshëm në televizionet - nga gjithsej 58 të anketuar, 39 janë përgjigjur se janë të punësuar në një stacion televiziv me kontratë të tillë, e pastaj te mediat – online (15 të anketuar).

Angazhimi i punës në baza të honorarit është më i zakonshmi në mediat online, ose nga gjithsej 27 të anketuar, 11 janë përgjigjur se kanë punuar për mediat online bazuar në një kontratë në vepër ose një kontratë autoriale.




2.2. Ngarkesa e punës (koha e punës, e drejta e pushimit, stresi në punë)

Parimi i pestë i Kartës për Kushtet e Punës të Gazetarëve përcakton se çdo gazetarë dhe punonjës mediatik ka të drejtë të pushimit dhe të kohës së lirë, që nënkupton numër të përshtatshëm të orëve të punës në ditët e punës, të drejtën e pushimit dhe të ashtuquajturës e drejta e shkyçjes, që nënkupton se pas mbarimit të kohës së punës, gazetari ka të drejtë të pushojë dhe t'i përkushtohet jetës së tij private, gjegjësisht të mos jetë i disponueshëm për redaktorin/punëdhënësin. Këto të drejta të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë ua garanton edhe Ligji për Marrëdhëniet e Punës, ndërsa duhet të jenë edhe në përbërjen e kontratave për punësim. Kjo do të thotë se punëdhënësi është i detyruar ta organizojë orarin e punës në kornizat e numrit të orëve të punës të përcaktuara me ligj (neni 116), t'u mundësojë punonjësve të shfrytëzojnë pauza dhe pushim ditor, javorë dhe vjetorë, dhe ta minimizojë ose plotësisht ta largojë punën jashtë orarit (neni 164)⁶.

6 Maja Atanasova, Të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fq. 12, Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë – SPGM dhe Instituti për Hulumtim të Zhvillimit Shoqëror RESIS, Shkup: 2024. Në dispozicion në: <https://cdn.ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2024/02/mkd-pravna-ramka-na-republika-severna-makedonija.pdf>



Në anketë janë bërë disa pyetje me qëllim që të kontrollohet se sa realizohen në praktikë këto të drejta të gazetarëve dhe punonjësve mediaticë: numri i përgjithshëm i orëve që i punojnë gazetarët dhe punonjësit mediaticë gjatë një jave pune, puna jashtë periudhave të përcaktuara të punës (punë me thirrje të punëdhënësit), puna jashtë përshkrimit të përcaktuar të detyrave të punës dhe të drejtën e dy ditëve pushim pas një jave pesëditore të punës.




Nga gazetarët e intervistuar, më shumë se gjysma (56%) janë përgjigjur se punojnë brenda orarit të përcaktuar me ligj, ndërsa te punonjësit mediaticë kjo përqindje është më e lartë (70%). Mbi kufirin e përcaktuar me ligj prej 50 orëve punojnë më shumë se një e katërta e gazetarëve (28%) dhe rreth një e dhjeta e punonjësve mediaticë (12%).

Specifikë e punës në sektorin e medias është ajo se orari i punës (e me këtë edhe koha e pushimit) vështirë mund të harmonizohet me rregullat e përcaktuara me ligj. Prandaj, si orët e punës ashtu edhe praktikat në sektorin e medias ndryshojnë shumë nga ato në shumë sektorë të tjerë. Nevoja për monitorim të rregullt të ngjarjeve dhe përpunim i shpejtë i përmbajtjeve imponon dinamikë të madhe në punë, veçanërisht në periudhat kur ndodhin ngjarje apo situata të jashtëzakonshme. Në kushte të tilla, gazetarët dhe punonjësit mediaticë shpesh duhet të punojnë përtej orarit të përcaktuar, domethënë të paraqiten në punë në thirrje urgjente nga redaktori ose punëdhënësi.


Këtu është e rëndësishme që të bëhet dallimi midis nevojave reale profesionale të medias (punëdhënësit) dhe barrës së tepërt (eksplantimit të fuqisë punëtore) të të punësuarve. Për shembull, nëse disa ngjarje kërkojnë mbulim gjatë gjithë ditës, kjo nuk mund të jetë një justifikim që një reporter apo kameraman të jetë i angazhuar në punë gjatë gjithë ditës, pa asnjë pushim. Në situatat e tilla, punëdhënësi duhet të vendosë turne, pra të punësojë dy ose më shumë gazetarë ose staf teknik. Dihet se shumë media, edhe ato më të mëdha, kanë numër të pamjaftueshëm punonjësish në redaksi dhe gazetarëve u kërkohet të punojnë në detyra të ndryshme dhe jashtë periudhave të përcaktuara të punës. Megjithatë, specifika e punës mediaticë nuk mund të përdoret si justifikim që gazetarët dhe punonjësit mediaticë të mos pushojnë gjatë ditës apo javës së punës. Asnjë dispozitë ligjore nuk u jep punëdhënësve të medias të drejtën të kërkojnë që gazetarët ose punonjësit e medias të jenë në dispozicion gjatë gjithë kohës.






Kjo praktikë e paligjshme dhe pasojat e saj në shëndetin mendor të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë u shqyrtua në anketë përmes disa pyetjeve të mëposhtme:

- Sa shpesh gazetarët dhe punonjësit mediatikë punojnë jashtë orarit të caktuar të punës?
- Sa shpesh kryejnë detyra të tjera pune, jashtë përshkrimit të përcaktuar?
- Sa shpesh respektohet në media e drejta për të pushuar gjatë javës së punës?
- Në çfarë mase gazetarët dhe punonjësit mediatikë janë të ekspozuar ndaj stresit gjatë punës së tyre?




Përgjigjet e të anketuarve në pyetjen e parë - sa shpesh punojnë jashtë orarit të caktuar të punës, tregojnë se gazetarët janë disi më të ekspozuar ndaj këtij lloji presioni: 13 për qind janë përgjigjur se vazhdimisht ose shpesh duhet të punojnë jashtë orarit të caktuar të punës dhe 27 për qind ndonjëherë. Më rrallë kërkohet nga punonjësit mediatikë: 6 për qind punojnë vazhdimisht ose shpesh jashtë orarit të rregullt të punës, dhe 17 për qind ndonjëherë.



Kryerja e detyrave të ndryshme të punës – jashtë asaj që është obligim i tyre i punës, vazhdimisht ose shpesh është për një të pestën (19%) e gazetarëve të anketuar, dhe 16 për qind janë përgjigjur se nganjëherë kërkohet një gjë e tillë. Përgjigjet e punonjësve mediatikë janë të ngjashme: 21 për qind vazhdimisht ose shpesh bëjnë punë të tjera, dhe 12 për qind ndonjëherë.




Sa respektohet e drejta për dy ditë pushim pas një jave pune pesëditore



Gazetarët më shpesh se sa punonjësit e medias ankohen për mosrespektimin e të drejtës për pushim dyditor në javën e punës: një e pesta (21%) janë përgjigjur se kjo e drejtë nuk respektohet asnjëherë ose rrallëherë në median ku ata punojnë, ndërsa 10 për qind e të anketuarve e kanë thënë këtë mes punonjësve mediatikë. Megjithatë, në të dyja kategoritë dominojnë të anketuarit të cilët janë përgjigjur se kjo e drejtë respektohet gjithmonë ose shpesh.

Ekspozimi ndaj stresit gjatë punës



Por, përgjigjet e pyetjes për ekspozimin ndaj stresit gjatë punës, jep tregues për shumë faktorë të tjerë, të cilët përveç ngarkesës së punës, ndikojnë negativisht në shëndetin mendor të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Më shumë se gjysma e gazetarëve të anketuar (55%) janë përgjigjur se shumë shpesh ose shpesh janë të ekspozuar ndaj stresit në punë. Ky është rasti me pothuajse një të tretën (32%) të punonjësve mediatikë.





3.E drejta për fitim - paga dhe kompensime

Ligji për Marrëdhëniet e Punës⁷ e rregullon të drejtën e të punësuarit për të ardhura në përputhje me ligjin, kontratën kolektive dhe kontratën për punësim. Ligji përcakton gjithashtu se paga përbëhet nga: paga bazë, një pjesë e pagës për suksesin në punë të punonjësit dhe kompensimet në pagë. Në ligj është përcaktuar se paga bazë përcaktohet duke marrë parasysh kërkesat e vendit të punës për të cilin punëmarrësi ka lidhur kontratën e punës. Paga bazë nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e përcaktuar me ligj. Në kontratën e punës shënohet shuma e pagës bazë bruto që do të marrë punonjësi.


Sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, kompensimet e pagës përcaktohen për kushte të veçanta gjatë punës, që dalin nga orari i punës, edhe atë për punë në: turne, punë me orar të ndarë, punë nate, punë në kujdestari, punë të zgjatur, punë në ditë pushimi javor dhe punë në ditë feste të përcaktuara me ligj. Përveç kësaj, punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë dhe shtesë për stazhin e punës.

Paga paguhet për periudha që nuk mund të jenë më të gjata se një muaj dhe jo më vonë se 15 ditë pas kalimit të afatit të pagesës. Punëdhënësi është i detyruar të njoftojë me shkrim punonjësin për ditën e pagesës dhe për çdo ndryshim në ditën e pagesës. Punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë punonjësit pagën e tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Për çdo pagesë të pagës, punonjësit duhet t'i jepet një llogaritje me shkrim të pagës, kontributeve në pagë dhe kompensimeve në pagë për periudhën specifike.

3.1. Shuma e pagave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë

Gjatë periudhës së anketimit, rreth 55 për qind e gazetarëve dhe rreth 77 për qind e punonjësve mediatikë kanë pasur të ardhura nën pagën mesatare mujore në vend, e cila në periudhën maj-tetor 2023 ishte 37.065,00 denarë.

Lartësia e pagës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë




Siç theksohet në shënimet metodologjike, vështrime krahasuese mund të nxirren vetëm për segmentet e mostrës, ku numri i të anketuarve është më i lartë - në mesin e shërbimit publik, stacioneve televizive kombëtare dhe mediave online. Mund të vërehen dallime të dukshme në pagat e gazetarëve të angazhuar në këto tre segmente: përqindja më e madhe (74,4%) e gazetarëve të anketuar në televizionin maqedonas kanë paga prej 30.000-40.000 denarë; në televizionet private në nivel kombëtar, 38,9 për qind të gazetarëve kanë paga nën 30.000; në sektorin online ka variacione më të mëdha të pagave: rreth 40 për qind të gazetarëve janë përgjigjur se kanë paga prej 30.000 deri 40.000 denarë, ndërsa një e trita e gazetarëve (32,8%) kanë paga mbi 50.000 denarë.

7 Nenet 106 dhe 105 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës





Krahësim i pagave në MTV, TV stacionet kombëtare dhe online mediumet



Nëse krahasoni pagat e punonjësve mediatikë në shërbimin publik dhe në televizionet kombëtare, mund të vëreni gjithashtu një ndryshim të dukshëm: në televizionet private 76.6 për qind e punonjësve mediatikë kanë pagë nga 20.000 deri në 30.000 dhe në MTV 77.8 për qind kanë pagë prej 30.000 deri në 40.000 denarë.

Krahësimi i pagave të punonjësve mediatikë në MTV, TV stacionet private në nivel kombëtar







3.2. Lartësia e pagave sipas gjinisë

Me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës⁸ është e garantuar barazi në lartësinë e pagave ndërmjet burrave dhe grave. Punëdhënësi-media është e obliguar që për punë të barabartë me kërkesa të barabarta në vendin e punës t'u paguajë paga të barabarta punëtorëve pa dallim gjinie.

Lartësia e pagave të gazetarëve - sipas gjinisë




Lartësia e pagave të punonjësve mediatikë sipas gjinisë




Krahasimi i të dhënave për lartësinë e pagave sipas gjinisë të të anketuarve tregon se nuk ka ndryshim domethënës në lartësinë e pagave ndërmjet burrave dhe grave, as te gazetarët, as te punonjësit mediatikë. Rreth 57 për qind e gazetarëve dhe 42 për qind e gazetareve kanë marrë pagë nën mesataren e pagës neto në vend të llogaritur për periudhën prej muajit maj deri në muajin tetor 2023. Te punonjësit mediatikë, gjendja është më e keqe: 80 për qind e burrave dhe 73 për qind e grave kanë marrë pagë nën mesataren në vend.

8 Neni 108 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës



3.3. Rregullsia e pagave dhe mënyra e pagesës

Sa i përket rregullsisë së pagave, nuk janë vërejtur dallime mes gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Numri më i madh i të anketuarve (85%) të përfshirë në anketë kanë deklaruar se paga e tyre paguhet rregullisht çdo muaj, 12% janë përgjigjur se është vonuar deri në një muaj, dhe vetëm 4% kanë thënë se paga e tyre është vonuar nga dy deri në tre muaj. Edhe pse në mostër nuk është përfshirë një numër i madh i të anketuarve nga mediat lokale, fakt është se në këtë sektor gjendja është më e keqe, si për nga shumica, ashtu edhe për nga rregullsia e pagave.



Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe rregulloret tjera ligjore përmbajnë rregulla të qarta në lidhje me mënyrën e pagesës së pagave për gazetarët dhe punonjësit e mediave. Në të kaluarën, shoqatat gazetareske dhe sindikale shpesh kanë paralajmëruar për mënyrat e paligjshme të pagesës së pagave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – një pjesë minimale e pagës është paguar në llogari transaksioni dhe pjesa tjetër direkt në dorë. Megjithatë, hulumtimi i bërë më parë nga SPGM-ja konfirmon se “ndryshe nga më parë, kur ndodhte shpesh që një pjesë e pagës paguhej në dorë, tani më shumë është përjashtim sesa rregull.”⁹


Ky konstatim konfirmohet edhe nga të dhënat e anketës së kryer në vitin 2023: shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të përfshirë në anketë janë përgjigjur se paga e tyre është paguar e plotë në llogarinë e transaksionit.

9 “SPGM: Të drejtat e mediave janë ende në lugë”, Radio Mof, 5 prill 2017. Në dispozicion në: <https://www.radiomof.mk/ssnm-pravata-na-mediumite-se-ushte-na-lazhicka/#prettyPhoto>





Mënyra e pagesës së pagave




3.4. Shtesa për punë jashtë orarit dhe punë në ditë festash

Punëdhënësit në çdo fushë janë të detyruar të mbajnë evidencë për punën jashtë orarit dhe punën në ditët e festave, me qëllim pagesën e saktë të shtesës së pagës për këto arsye. Puna jashtë orarit dhe puna gjatë festave pa kompensim konsiderohej si një nga tiparet e shpeshta dhe tipike të punës së pasigurt të gazetarëve dhe punonjësve të medias.

Anketa tregoi se edhe në vitin 2023 ky fenomen ishte i shpeshtë në sektorin e medias: 52 për qind e gazetarëve dhe 48 për qind e punonjësve të medias janë përgjigjur se e drejta e pagesës jashtë orarit nuk respektohet në mediat ku ata punojnë.


Sa respektohet e drejta e kompensimit për punën jashtë orarit të punës?



E ngjashme është situata edhe sa i përket të drejtës për kompensim për punë në ditë festash: 49 për qind e gazetarëve dhe 41 për qind e punonjësve mediatikë janë përgjigjur se kjo e drejtë rrallë ose kurrë nuk respektohet. Kështu ndodh më shpesh në mediat private dhe shumë më rrallë në shërbimin publik.




Sa respektohet e drejta e kompensimit të punës në ditë festash?



Nëse punëdhënësi nuk ka një orar fiks ose e ndryshon atë në situata emergjente, pa i informuar punonjësit, është shumë e vështirë të përcaktohet se sa orë jashtë orarit punojnë gazetarët dhe punonjësit e medias. Këto probleme në sferën mediatike do të mund të zgjidheshin duke vendosur detyrime të veçanta për punëdhënësit (për shembull, në Ligjin për Media ose në marrëveshjen kolektive), në aspektin e vendosjes së një orari të punës, informimin e punonjësve për këtë orar, njoftimin në kohë të ndryshimeve në orarin në situata emergjente etj. Ajo do t'u lejojë gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që të ekspozohen më pak ndaj stresit, por edhe të vendosen evidenca të sakta për punën jashtë orarit dhe punës gjatë festave.





4. Të drejtat që lidhen me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor


Anketa shtroi edhe disa pyetje për disa nga të drejtat e tjera të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, të cilat rrjedhin nga Ligji për Marrëdhëniet e Punës:

- e drejta e sigurimit shëndetësor;
- e drejta për ekzaminim shëndetësor sistematik;
- e drejta e shfrytëzimit të pushimit mjekësor;
- e drejta për leje lehonie/prindërore.

4.1. E drejta e sigurimit shëndetësor

Të drejtat që lidhen me detyrimet e punëdhënësit, në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë gjatë punës, janë shumë më komplekse dhe duhet të jenë objekt i një hulumtimi të veçantë. Për shkak të kufizimit kohor, në këtë anketë janë bërë vetëm disa pyetje në lidhje me mundësitë e shfrytëzimit të të drejtës për kujdes shëndetësor që rrjedh nga sigurimi shëndetësor (e drejta për të shfrytëzuar pushimin mjekësor, e drejta për ekzaminim sistematik shëndetësor, e drejta për leje lehonie/prindërore).

Çfarë lloji të sigurimit shëndetësor keni?



Gjatë llogaritjes së pagës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, në përqindje të pagës bruto, punëdhënësi llogarit dhe paguan edhe kontributet sociale për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, sigurimin e detyrueshëm shëndetësor dhe/ose kontributin shtesë për sigurim shëndetësor në rast dëmtimi në punë dhe sëmundjes profesionale. Nga përgjigjet e marra nga anketa, mund të konstatohet se madje 90% e të anketuarve kanë sigurim shëndetësor të detyrueshëm, që do të thotë se punëdhënësit ua paguajnë këtë kontribut social me pagën e tyre.




4.2. Të drejtat që rrjedhin nga sigurimi shëndetësor

Punonjësi ka të drejtën e kompensimit të pagës për gjithë kohën e mungesës në rastet e paaftësisë së përkohshme për punë për shkak të sëmundjes ose lëndimit, si dhe për shkak të mungesës nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë/prindërimit, me kusht që të jetë i siguruar dhe të ketë krijuar marrëdhënie të përhershme pune.


Nga përgjigjet e të anketuarve në anketë, mund të konstatohet se pothuajse nuk ka raste kur kjo e drejtë nuk respektohet në asnjë sektor mediatic.


Deri në çfarë mase media juaj e respekton të drejtën për...



Mirëpo, e drejta për një ekzaminim të detyrueshëm sistematik realizohet shumë më rrallë: vetëm rreth 40 për qind e të anketuarve në vitin e kaluar kanë pasur ekzaminim sistematik shëndetësor të organizuar nga media.

Para sa kohe keni qenë në një ekzaminim sistematik të organizuar prej mesdias...





5. Kënaqësia me punën dhe mjedisin më të gjerë

Në mjedisin vazhdimisht në ndryshim dhe të pasigurt në të cilin punojnë mediat, motivimi dhe kënaqësia në punë e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë është e një rëndësie kyçe për nivelin e profesionalizmit dhe cilësisë së përmbajtjes që ata prodhojnë.


Pyetjet e parashtruara nga anketa mbulojnë disa dimensione të rëndësishme të kënaqësisë së gazetarëve dhe punonjësve të medias me kushtet e punës dhe mjedisin në të cilin ata punojnë:

- Kënaqësinë me zhvillimin e karrierës së tyre, mundësitë për arsimim dhe zhvillim profesional dhe kënaqësinë me cilësinë e produkteve që krijojnë;
- Ndikimi i punës në jetën e tyre private dhe vlerësimi i punës;
- Mbështetja që marrin nga kolegët dhe eprorët;
- Shkalla e autonomisë personale në punë dhe perceptimet për nivelin e lirive të përgjithshme në vend.

5.1. Karriera, edukimi dhe kualiteti i përmbajtjes së krijuar

Dimensioni i parë i referohet masës në të cilën puna përmbush pritshmëritë e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë për zhvillim personal dhe aktualizim profesional. Kështu, anketa tregoi se një përqindje e madhe e gazetarëve dhe punonjësve të medias janë të kënaqur me mënyrën se si po zhvillohet karriera e tyre: 78 për qind e gazetarëve dhe 81 për qind e punonjësve të medias janë plotësisht ose kryesisht të kënaqur.


Sa jeni të kënaqur me shkallën e autonomisë në punë?



Nga ana tjetër, përvojat në lidhje me mundësitë për arsimim shtesë dhe zhvillim profesional janë të ndara: 41 për qind e gazetarëve të anketuar janë përgjigjur se janë (plotësisht ose kryesisht) të pakënaqur, dhe 38 për qind se janë të kënaqur me mundësitë për zhvillim profesional që ua mundësojnë mediat në të cilat punojnë. Punonjësit mediatikë, në përgjithësi, kanë shprehur më shumë pakënaqësi sesa gazetarët: 52 për qind u përgjigjën se janë (plotësisht ose kryesisht) të pakënaqur, ndërsa 31 për qind se janë të kënaqur. Kjo do të thotë se në disa media ekziston më shumë shqetësim për këtë çështje, e në të tjera jo.




Sa jeni të kënaqur me mundësitë për arsimim shtesë dhe zhvillim profesional?



Pyetja e tretë në këtë segment, i referohej shkallës së kënaqësisë me cilësinë e produktit profesional të krijuar nga gazetarët dhe punonjësit mediatikë gjatë punës së tyre. Përgjigjet e të anketuarve tregojnë një nivel të lartë të vetëvlerësimit të punës së tyre, gjë që mund të duket e palogjikshme nëse krahasohet me pakënaqësinë e shprehur nga të anketuarit në lidhje me mundësitë për arsimim dhe trajnim shtesë.

Sa jeni të kënaqur me atë që krijoni si produkt të punës suaj?




5.2. Balanca ndërmjet punës dhe jetës private dhe vlerësimi i punës


Dimensioni tjetër i kënaqësisë me mjedisin e punës lidhet me ndikimin e punës në jetën private të të anketuarve dhe qëndrimet e tyre se sa vlerësohet puna e tyre. Kjo, natyrisht, lidhet me atë se sa respektohen orari i caktuar i punës, sa detyrohen të anketuarit të punojnë në ditë festash dhe nëse mendojnë se puna e tyre është e paguar mjaftueshëm.

Përgjigjet në pyetjen e parë - për atë se sa të kënaqur janë të anketuarit me balancën ndërmjet punës dhe jetës private, tregojnë se gazetarët më shpesh vuajnë nga presioni i punës në jetën e tyre private, gjë që u konfirmua edhe nga përgjigjet e tyre për ngarkesën e punës (Pjesa 2.2 - Ngarkesa e punës). Pak më pak se një e treta e gazetarëve të anketuar (29%) janë përgjigjur se janë kryesisht ose plotësisht të pakënaqur me balancën mes punës dhe jetës së tyre private. Sigurisht, ky vlerësim ndryshon në varësi të sektorit ku ata punojnë - shërbim publik apo media private, në një media me redaksi më të madhe apo në një media të vogël.






Sa jeni të kënaqur me balancën ndërmjet punës dhe jetës private?



Pyetja tjetër në këtë bllok ishte për shkallën e kënaqësisë me shumën e të ardhurave personale. Përgjigjet e marra tregojnë opinione të ndara, të cilat mund të jenë reflektim i ndonjë forme konformizmi apo apatie mes gazetarëve dhe punonjësve mediatikë për shkak të pasigurisë afatgjatë të vendeve të punës në media. Përveç kësaj, ky perceptim është ndoshta rezultat i situatës në mjedisin më të gjerë socio-politik (niveli i pagave në sektorë të tjerë, gjendja e përgjithshme ekonomike në vend, etj.).


Sa jeni të kënaqur me të ardhurat tuaja personale?




Pak më shumë se një e treta (35%) e gazetarëve janë përgjigjur në mënyrë eksplicite se janë (kryesisht ose plotësisht) të pakënaqur me të ardhurat e tyre personale, por më shumë se një e treta (39%) janë të kënaqur. Në mesin e punonjësve të mediave, është më e ulët përqindja (26%) e të anketuarve që janë shprehur të kënaqur me shumën e pagave, por është dukshëm më e lartë tek ata që nuk kanë mendim për këtë.

5.3. Mbështetje nga eprorët dhe kolegët


Dimensioni i tretë i kënaqësisë janë marrëdhëniet me eprorët dhe kolegët. Në përgjithësi, anketa tregon se gazetarët dhe punonjësit mediatikë janë të kënaqur nga marrëdhëniet në kuadër të redaksive - si me eprorët ashtu edhe me kolegët. Pakënaqësia disi më e qartë shprehet nga marrëdhëniet me eprorët - një e pesta (20%) e gazetarëve dhe pak më pak se një e pesta (18%) e punonjësve të medias janë (kryesisht ose plotësisht) të pakënaqur me eprorët e tyre.



Sa jeni të kënaqur me marrëdhënien dhe mbështetjen nga eprorët tuaj?




Sa jeni të kënaqur me marrëdhënien dhe mbështetjen nga kolegët tuaj?



5.4. Autonomia personale dhe perceptimet për liritë e medias në vend



Në këtë bllok pyetjesh, në fund, të anketuarve iu kërkua të vlerësojnë shkallën e autonomisë së tyre në procesin e punës, por gjithashtu, edhe të vlerësojnë shkallën e lirisë së medias në vend, në përgjithësi.

Sa jeni të kënaqur me shkallën e autonomisë në punë?



Dallimet në vlerësimet e të anketuarve për lirinë e tyre dhe për lirinë e mediave në përgjithësi në vend janë të dukshme. Për shembull, shumica (78%) e gazetarëve të anketuar janë të kënaqur (kryesisht ose plotësisht) me autonominë që kanë gjatë procesit të punës. Por kur bëhet fjalë për nivelin e përgjithshëm, vetëm 18 për qind mendojnë se media ka liri të plotë ose të madhe. Rreth 56 për qind janë përgjigjur se mediat janë vetëm disi të lira.





Punonjësit mediatikë kanë një qëndrim më kritik sesa gazetarët për lirinë e medias: 45 për qind janë përgjigjur se mediat në vend kanë pak ose aspak liri.



6. Organizimi sindikal


Karta për Kushtet e Punës së Gazetarëve si parim të parë, e rikonfirmon të drejtën e tyre për t'u anëtarësuar në shoqatat dhe organizatat sindikale të tyre për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të punës. Kjo e drejtë përfshin lirinë e organizimit sindikal në mediat në të cilat punojnë gazetarët (këshillet editoriale, komisionet e punonjësve, grupet sindikale etj.), të drejtën për të diskutuar me menaxhmentin për të drejtat e tyre të punës dhe të gazetarisë, si dhe të drejtën për qasje në dokumente dhe informacione me të cilat promovohen marrëdhëniet e punës në redaksitë e mediave. Të njëjtat të drejta gazetarëve dhe punonjësve mediatikë u garantohen me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.

Anketa, ndër të tjera, kishte për qëllim edhe të përcaktojë motivimin e të anketuarve për anëtarësim në organizatat sindikale dhe cilat janë qëndrimet dhe perceptimet e tyre për punën e sindikatave.

6.1. Anëtarësimi në organizata sindikale

Nga numri i përgjithshëm i gazetarëve të anketuar të përfshirë në anketë, 58 për qind janë përgjigjur se nuk janë anëtarë të asnjë organizate sindikale, ndërsa 42 për qind janë anëtarë të një ose më shumë organizatave sindikale. Treguesit janë të ngjashëm për punonjësit mediatikë të anketuar: 62 për qind nuk janë anëtarë askund, dhe 38 për qind janë anëtarë të një ose më shumë organizatave sindikale.


Anëtarësimi në organizata sindikale (OS)




Të anketuarit të cilët janë përgjigjur se nuk janë anëtarë të asnjë organizate sindikale janë pyetur për arsyet e mundshme të mungesës së interesimit të tyre për t'u anëtarësuar në sindikata. Përgjigjet e marra tregojnë se:

- frika nga pasojat e mundshme që do të pësonin nga punëdhënësi nuk është arsye për mos anëtarësim: rreth 87 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ky qëndrim nuk vlen për ta;
- për një pjesë të madhe të gazetarëve (67%) dhe për 46 për qind të punonjësve mediatikë, nuk është arsye ajo që nuk ka një sindikatë që merret me problemet e profesionit të tyre;
- besimi se nuk do të përfitonin nga anëtarësimi në sindikata është arsye për 42 për qind të gazetarëve dhe 46 për qind të punonjësve mediatikë;
- 45 për qind e gazetarëve dhe 55 për qind e punonjësve mediatikë janë pajtuar se arsyeja është *informimi i pamjaftueshëm i tyre për punën e sindikatës*.






Arsyet e mundshme pse gazetarët nuk janë anëtarë të organizatave sindikale



Arsyet e mundshme pse punonjësi mediatikë nuk janë anëtarë të organizatave sindikale



6.2. Perceptime të përgjithshme për punën e sindikatave


Të gjithë të anketuarve në anketë, si ata që janë anëtarë dhe ata që nuk janë anëtarë të sindikatave, u janë drejtuar disa pyetje në lidhje me pikëpamjet e tyre për organizimin dhe suksesin e sindikatave, si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj ndikimeve dhe presioneve nga burime të ndryshme të pushtet. Përgjigjet e marra tregojnë perceptimet e mëposhtme të përgjithshme të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë:

- Tek të dyja kategoritë e të anketuarve dominon qëndrimi se sindikatat lehtë mund të bien nën ndikime politike: 63 për qind e gazetarëve dhe 65 për qind e punonjësve të medias janë dakord (plotësisht ose kryesisht) me këtë qëndrim;
- Më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se sindikatat lehtë mund të korruptohen ose të bien nën ndikimin e interesave të korporatave: 56 për qind e gazetarëve dhe 56 për qind e punonjësve mediatikë pajtohen me këtë (plotësisht ose kryesisht);
- Një përqindje e konsiderueshme e gazetarëve (45%) dhe punonjësve të medias (46%) pajtohen me qëndrimin se fuqia e sindikatave varet nga aftësia e menaxhmentit të tyre për të siguruar fonde dhe më pak nga iniciativa;
- Më shumë se gjysma e punonjësve mediatikë (53%) besojnë se sindikatat nuk mund të mbrojnë të drejtat e punonjësve. Këtë qëndrim e kanë 46 për qind e gazetarëve të intervistuar.





- Ekzistojnë mendime të ndara dhe paqartësi në mesin e të anketuarve lidhur me qëndrimin se kolegët e tyre nuk anëtarësohen në sindikata nga frika e pasojave për vendin e tyre të punës.

Qëndrimet e gazetarëve për organizatat sindikale (SO)



Qëndrimet e punonjësve mediataikë për organizatat sindikale (SO)





7. Përfundime dhe rekomandime

Modelet e angazhimit të punës (llojet e kontratave të punës)

Anketa tregoi se, ndryshe nga e kaluara, kur një numër i madh gazetarësh dhe punonjës mediatikë angazhoheshin me kontrata në kohë të caktuar ose në bazë të honorarit, sot situata ka ndryshuar ndjeshëm. Shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë të anketuar (rreth 70%) kanë një kontratë pune me kohë të pacaktuar me orar të plotë, e cila u mundëson atyre të kenë një status të qëndrueshëm punësimi dhe të ushtrojnë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Megjithatë, në disa sektorë të medias, praktikohet ende punësimi i gazetarëve dhe punonjësve të medias me kontrata me afat të caktuar (17% e të dyja kategorive të të anketuarve) ose në bazë të honorarit - me kontratë autoriale ose me kontratë në vepër (7% e gazetarë dhe 9% të punonjësve mediatikë). Punësimi me kontratë për një periudhë të caktuar është më i zakonshëm në televizion dhe media, ndërsa angazhimi në bazë të honorarit është më i zakonshëm në mediat online.

Në përgjithësi, rreth një e katërta e gazetarëve (24%) dhe punonjësve mediatikë (26%) nuk kanë punësim, që u mundëson plotësisht të kenë një status të qëndrueshëm dhe të sigurt punësimi dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre të punësimit. Natyrisht, grupi më i cenusshëm në këtë drejtim janë gazetarët dhe punonjësit mediatikë të punësuar në bazë të kontratës në vepër ose kontratë autoriale.

Anketa konfirmoi se numri i gazetarëve të vetëpunësuar ose punonjësve mediatikë (freelancer) në vend është i vogël: nga gjithsej 343 të anketuar, vetëm 5 janë përgjigjur se kanë një status të tillë pune.

Rekomandime:

- Nga pikëpamja e standardeve ndërkombëtare dhe rregulloreve të brendshme për marrëdhëniet e punës, është e rëndësishme të përcaktohet më tej: (a) nëse kontratat e punës përmbajnë të gjithë elementët e garantuara (vendi i punës, sasia dhe mënyra e llogaritjes së pagës, orari i punës, periudhat e pushimit etj.), dhe (b) nëse gazetarit apo punonjësit mediatik i është lejuar të negociojë lirisht me punëdhënësin për kushtet e punës përpara lidhjes së kontratës.
- Është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohen arsyet pse lidhen kontrata me kohë të caktuar në sektorë të caktuar dhe nëse punëdhënësit respektojnë detyrimin, pas skadimit të afatit të caktuar, për ta shndërruar punësimin e përkohshëm në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar.

Ngarkesa e punës (orari i punës, e drejta për pushim, stresi i punës)

Punëdhënësit në sektorin e medias, si dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera, janë të detyruar me vendim të veçantë të përcaktojnë orarin e punës brenda numrit ligjor të orëve të punës, duke marrë parasysh të drejtën e pushimit ditor, javor dhe vjetor të punonjësve të tyre dhe duke u përpjekur, ta minimizojnë kohën e punës shtesë. Punonjësit duhet të informohen në kohë për çdo ndryshim në orarin e punës.

Dinamika e punës në sektorin e medias, veçanërisht në median e përditshme, kërkon përpjekje serioze organizative dhe burime të mjaftueshme njerëzore për të realizuar këto të drejta të gazetarëve dhe punonjësve të medias. Të dhënat e marra nga hartimi i



popullsisë, si dhe nga vetë anketa, treguan se vitin e fundit në shumë redaksi (veçanërisht në media private në nivel rajonal dhe lokal) numri i të punësuarve është ulur dhe se kjo, pa dyshim, rrit barrën dhe stresin e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë që janë të punësuar rregullisht.

Kështu, përgjigjet e marra nga anketa treguan se më shumë se një e katërta e gazetarëve të anketuar (28%) punojnë përtej orarit të lejuar ligjërisht, ndërsa rreth një e pesta punojnë detyra pune që janë jashtë përshkrimit të përcaktuar të punës. Gjithashtu, një e pesta e gazetarëve nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për dy ditë pushim në javë. Të dhënat më shqetësuese janë se mbi gjysma e gazetarëve (55%) janë shumë shpesh ose shpesh të ekspozuar ndaj stresit.

Pavarësisht nga specifikat e punës mediatike dhe gjendjes financiare të medias specifike, është e papranueshme që gazetarët ose punonjësit e medias të punojnë vazhdimisht më gjatë se numri i lejuar i orëve të punës në javë, të mos jenë në gjendje të shkëputen nga detyrat e punës ose të duhet të jenë vazhdimisht të disponueshëm për punëdhënësin.

Rekomandime:


- Për të tejkaluar këtë situatë, është e rëndësishme të përcaktohet nëse të gjitha mediat kanë marrë një vendim me të cilin përcaktohet orari i punës, nëse ai orar është bërë duke marrë parasysh numrin maksimal të orëve të punës dhe të drejtën për pushime, sa shpesh ndryshohet orari, nëse punonjësit janë të informuar me kohë për orarin etj.
- Me qëllim të tejkalohet fenomeni ku gazetarëve dhe punonjësve të medias u jepen detyra të tepërta për të njëjtën pagë - të cilat shkojnë përtej fushëveprimit të specializimit dhe përshkrimit të punës së tyre, është e rëndësishme të përcaktohet detyrimi i punëdhënësit për miratimin e një akti të brendshëm organizativ dhe përshkrimin e vendeve të punës, në bazë të së cilës përshkrimi i vendit të caktuar të punës do të përfshihet në kontratën e punës së personit të punësuar.
- Gjatë miratimit të Ligjit të ri për Media, rekomandohet që botuesve të mediave t'u vendoset detyrimi për miratimin e akteve themelore organizative, duke përfshirë një vendim të veçantë për përcaktimin e orarit të punës në përputhje me rregulloret në fushën e ligjit të punës.

E drejta e fitimit (pagat dhe shtesat)

Një nga tiparet tipike të punës së pasigurt në sektorin e medias, për të cilën u shkrua shumë shpesh në të kaluarën, ishin pagat e ulëta dhe të parregullta, puna papaguar jashtë orarit dhe puna në ditë festash. Kjo situatë, në një masë të madhe, ka ardhur si pasojë e gjendjes së tregut mediatik, por edhe e politikave që janë ndërtuar apo zbatuar në të kaluarën në këtë fushë. Është theksuar shumë herë se në vend, tregu mediatik është i mbingopur dhe se ka shumë media private për një ekonomi kaq të vogël dhe të pazhvilluar. Në një konkurrencë kaq të fortë, media private gjeneroi pak të ardhura dhe investoi pak në burime njerëzore dhe zhvillim.

Si procesi i hartimit të popullatës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë ashtu edhe anketa i konfirmuan pjesërisht këto njohuri të mëparshme. Numri i të punësuarve është në rënie të vazhdueshme, veçanërisht në mediat private lokale dhe rajonale, të cilat realizojnë të ardhura të ulëta nga reklammat. Profesionit i gazetarisë është jo mjaftueshëm i vlerësuar - mbi gjysma e gazetarëve (55%) kanë të ardhura nën pagën mesatare mujore në RMV, ndërsa në mesin e punonjësve mediatikë kjo përqindje është më e lartë (77%). Ka dallime





në paga në sektorë të ndryshëm: ato janë më të larta në shërbimin publik dhe më të ulëta në televizionet private. Dhe në sektorin online ka ndryshime të mëdha.

Përveç këtyre gjetjeve, ka edhe të dhëna që tregojnë se dispozitat ligjore për rritjen e të ardhurave në masë të madhe nuk respektohen: puna jashtë orarit nuk është paguar për 38 për qind të gazetarëve dhe 36 për qind të punonjësve mediatikë të përfshirë në anketë. 46 për qind e të gjithë të anketuarve nuk u janë paguar kurrë ose rrallëherë kompensim për punën gjatë festave.

Rekomandime:

- Është e rëndësishme të përcaktohet nëse punëdhënësit në sektorin e medias respektojnë dispozitat ligjore për mbajtjen e evidencës së rregullt të punës jashtë orarit dhe punës gjatë festave. Të dhëna të tilla janë një kërkesë që të mund në mënyrë të saktë të përcaktohet e drejta e punonjësit për të ardhura të rritura, domethënë t'i paguhet atij kompensim për punën jashtë orarit dhe punën gjatë festave.
- Në Ligjin e ri për Media, përveç akteve të tjera dhe vendimit për përcaktimin e orarit të punës, botuesit e mediave duhet të angazhohen dhe të mbajnë shënime të sakta për punën jashtë orarit dhe punën gjatë festave.

E drejta për sigurim shëndetësor dhe mbrojtja shëndetësore

E drejta për sigurim shëndetësor dhe mbrojtja shëndetësore është pjesë e një korpusi më të gjerë të të drejtave që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen gjatë punës. Megjithatë, për shkak të shtrirjes së masave që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen, në këtë anketë janë përfshirë vetëm disa aspekte të së drejtës për shëndet dhe mbrojtje shëndetësore. Punëdhënësit në sektorin e medias, ndër të tjera, janë të detyruar që: gjatë llogaritjes së pagës, t'i paguajnë punonjësit kompensim për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor, të paguajnë dëmshpërblim në rast sëmundjeje ose lëndimi, të monitorojnë gjendjen shëndetësore të të punësuarve dhe t'ju sigurojnë atyre kontroll sistematike shëndetësore.


Nga përgjigjet e marra me anketë, mund të konstatohet se madje 90 për qind e të anketuarve kanë sigurim shëndetësor të detyrueshëm dhe se e drejta për pushim mjekësor të paguar dhe pushim prindëror është realizuar pothuajse plotësisht. Megjithatë, vetëm rreth 40 për qind e të anketuarve në vitin e kaluar kishin një kontroll sistematik shëndetësor të organizuar nga media. Kjo, ndër të tjera, tregon për mungesë kujdesi nga ana e punëdhënësve, sidomos duke pasur parasysh se një përqindje e madhe e gazetarëve dhe punonjësve të medias ankohen për stresin të cilit i ekspozohen gjatë punës.

Rekomandim:

- Duke pasur parasysh gamën e detyrimeve të punëdhënësve, në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes për shëndetin fizik dhe mendor të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje e veçantë të gjithë korpusit të çështjeve që lidhen me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

Kënaqësia me punën dhe mjedisin

Disa pyetje në anketë i referoheshin shkallës së kënaqësisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë me kushtet e punës dhe mjedisin ku ata punojnë, si dhe shkallën e autonomisë personale në punë dhe perceptimet për nivelin e lirive të përgjithshme në vend. Ekspozimi ndaj stresit dhe kushteve abuzive ende të pranishme në punën e gazetarëve dhe punonjësve



mediatikë reflektohet në ndjenjën e tyre të demotivimit dhe konformitetit, dhe kjo, nga ana tjetër, çon përfundimisht në autocensurë, në dorëzim ndaj presionit dhe në cilësi të ulët profesionale të produkteve gazetareske dhe mediatiche.

Anketa tregoi se një pjesë e madhe e të anketuarve gazetarë dhe punonjës mediatikë (rreth 80%) shprehin kënaqësi për mënyrën se si po zhvillohet karriera e tyre dhe për cilësinë e produkteve që krijojnë, por megjithatë janë të pakënaqur me mundësitë për zhvillim dhe edukim të mëtejshëm.

Gazetarët më shpesh se punonjësit mediatikë ankohen për ndikimin e punës së tyre në jetën e tyre private, por ky vlerësim ndryshon në varësi të sektorit ku ata punojnë - shërbimi publik apo media private, në një media në të cilin ka një redaksi më të madhe apo në një media të vogël. Për sa i përket kënaqësisë prej pagave, opinionet janë të ndara, pra nuk korrespondojnë me të ardhurat vërtet të ulëta në të gjithë sektorin mediatik. Përgjigje të tilla duket se pasqyrojnë konformitetin ose apatinë midis gazetarëve dhe punonjësve mediatikë për shkak të pasigurisë në vendet e punës në media.

Të anketuarit në anketë kanë dhënë nota të larta për autonominë e tyre të punës në median ku punojnë, por shumica kanë shprehur qëndrime kritike për liritë e përgjithshme të medias në vend.

Rekomandime:


- Nga këto gjetje, rekomandim i përgjithshëm për organizatat sindikale është që në përfaqësimin e tyre të mos kufizohen vetëm në të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, por të punojnë në vazhdimësi për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe lirinë e gazetarëve në përgjithësi, si brenda vendit të punës ashtu edhe në shoqëri në tërësi.
- Kënaqësia e gazetarëve me pozicionin e tyre të punës lidhet drejtpërdrejt me mundësitë për avancim dhe arsimim gjatë karrierës së tyre. Në kushtet kur vetë redaksitë nuk kujdesen sa duhet për nevojën e avancimit profesional të punonjësve të tyre, janë organizatat sindikale ato që duhet të punojnë në krijimin e mundësive për trajnim të vazhdueshëm dhe zhvillim profesional të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë.

Organizimi sindikal

Anketa konfirmoi njohuritë e mëparshme se gazetarët dhe punonjësit e medias kanë ende pak motivim për t'u anëtarësuar në sindikata dhe për të krijuar organizatat e tyre sindikale. Në identifikimin e arsyeve për këtë, frika nga pasojat për vendin e punës nuk është arsyeja e vetme dhe më e madhe, por edhe perceptimet e krijuara për pavarësinë dhe suksesin e organizatave sindikale.

Dy të tretat e të anketuarve besojnë se sindikatat bien lehtësisht nën ndikimin politik dhe pak më shumë se gjysma se ato mund të korruptohen ose të bien nën ndikimin e interesave të korporatave. Rreth gjysma e të anketuarve besojnë se motivimi i ulët për t'u anëtarësuar në sindikata është për shkak të besimit se sindikatat, në fakt, janë të paafta dhe të pafuqishme për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve në sferën mediatiche. Perceptime të tilla ndoshta janë kryesisht për shkak të mënyrës së punës së organizatave individuale sindikale, por edhe të bindjeve të përgjithshme për besueshmërinë dhe suksesin e organizimit sindikal në vend.





Rekomandime:


- Për të ndryshuar bindjet dhe perceptimet e tilla, organizatat sindikale në sferën mediatike duhet të punojnë vazhdimisht në forcimin e besueshmërisë së tyre, si në radhët e anëtarëve ashtu edhe në mesin e gjithë popullatës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. Në të njëjtën kohë, është e një rëndësie kyçe që në komunikim me të gjithë aktorët të përcaktohen qartë dhe të theksohen parimet kryesore mbi të cilat bazohet puna e sindikatave: demokracia, pavarësia, etika profesionale dhe integriteti.
- Lokalizimi i vendndodhjes së saktë të problemeve specifike me të cilat përballen punonjësit në sektorë të ndryshëm mediatik duhet të jetë bazë për zhvillimin e një qasjeje të përshtatshme gjatë negociatave kolektive për të zgjidhur problemet me të cilat përballen gazetarët dhe punonjësit e medias: orari i punës dhe ngarkesa e punës, shuma e pagave dhe përfitimeve, pagesa e punës jashtë orarit, sigurinë dhe mbrojtjen shëndetësore dhe një sërë kushtesh dhe të drejtash të tjera në procesin e punës.



8. Literatura e shfrytëzuar

1. *Atanasova, Maja, Të drejtat e punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – SPGM dhe Instituti për hulumtim të zhvillimit shoqëror- RESIS, Skopje: 2024. <https://cdn.ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2024/02/alb-korniza-ligjore-e-republikes-se-maqedonise-se-veriut.pdf>
 2. *Atanasova, Maja, Mbrojte dhe mundësi për realizimin e të drejtave të punës të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë - Analizë krahasuese*, Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – SPGM dhe Instituti për hulumtim të zhvillimit shoqëror- RESIS, Skopje: 2024. https://cdn.ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2024/03/komparativna_analiza_mkd_lrij_ssnm_resis.pdf
 3. *Bejkova Joshevska, Biljana dhe Dzigal, Sead, Me veprim të përbashkët deri tek respektimi më i madh i të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë*, Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – SPGM, Skopje: 2022. <https://cdn.ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2022/02/Bezbedni-Mediumski-Rabotnici-Analiza-Book-WEB-ALB-1.pdf>
 4. *Kallamatiev, Todor dhe Ristovski, Aleksandar, 'Statusi juridik i punës dhe pozita prekariate e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë në Republikën e Maqedonisë'*, e publikuar në *Punimet e Konferencës Ndërkombëtare "Media dhe të Drejtat e Njeriut"*, fq.245-261. Universiteti "Shën Kirill dhe Metodij", Fakulteti Juridik "Justinijani i Parë", Shkup:2016 <https://repository.ukim.mk/handle/20.500.12188/6516>
 5. *Popoviq, Jasmina dhe të tjerë, Punë prekariati në industrinë mediatike*, Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – SPGM, Skopje: 2014. <https://ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2014/11/Prekarna-rabota-vo-mediumskata-industrija-fin.pdf>
 6. *Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatikë – SPGM, Libër i bardhë për të drejtat profesionale dhe të punës të gazetarëve*, Skopje: 2014. <https://ssnm.org.mk/wp-content/uploads/2014/05/Bela-kniga-mak.pdf>
 7. *Tuneva, M., Punësimi dhe kushtet e punës për gazetarët e Republikës së Maqedonisë*, Instituti për media i Maqedonisë, Shkup: 2015. https://mim.org.mk/attachments/article/829/Vrabetuvanjeta_I_rabotnite%20uslovi_na_novinarite_vo_RM.pdf
- * * *
8. *Camović, Marijana, Radno-pravni status novinarar u Crnoj Gori: Novinarstvo izmedju straha za egzistenciju i dostojanstva profesije*, Institut za medije Crne Gore, Podgorica: 2015. https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/cg_res2.pdf
 9. *Džihana, Amer, Istraživanje o radnim uslovima i pravima novinarar/ki, zakonski okvir i upravljanje lokalnim medijima u BiH*, BH Novinari, Sarajevo: 2021. <https://bhnovinari.ba/wp-content/uploads/2021/02/RADNA-PRAVA-FINALNI-IZVJESTAJ.pdf>
 10. *European Federation of Journalists, Rights and Jobs in Journalism: Building Stronger Unions in Europe*, Brussels, 2016. https://europeanjournalists.org/wp-content/uploads/2016/11/EFJ_handbook_web_cor.pdf





11. Krstić, Iskra & Momčilović, Predrag, *Širom zatvorenih očiju: Koliko novinarke i novinari poznaju svoja radna prava?*, Nezavisno udruženje novinara Srbije, Beograd, 2021
<https://nuns.rs/media/2022/01/ISTRAZIVANJE-RADNA-PRAVA-ver01-1.pdf>
12. Milić, Veljko et al., *Perception of Socio-economic Position of Journalists and Media Workers in Vojvodina*, Novi Sad, 2022. https://www.osce.org/files/f/documents/0/3/482598_0.pdf
13. Reljanović, Mario, *Analysis of the Labour Status of Journalists and Media Workers in Serbia with Recommendations for Improvement*, OSCE Mission to Serbia, Belgrade: 2021.
<https://www.osce.org/files/f/documents/8/d/509714.pdf>
14. Spilsbury, Mark, *Journalists at Work: Their Views on Training, Recruitment and Conditions*, National Council for the Training of Journalists, London: 2018.
<https://www.nctj.com/publications/journalists-at-work-2018/>

